AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Janar 2024

23.02.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin janar 2024.

Rritet skema për pensionet paraplegjik dhe tetraplegjik në janar 2024, krahasuar me janar 2023

Në muajin janar 2023, nga skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike kanë përfituar 2 971, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 2 470 perfitues, vërehet një rritje prej 20,3%.

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti		12.2024/
	01.2023	01.2024	01.2022
Skema e ndihmës sociale	22 571	20 251	-10,3%
Pensionet bazike të moshës	140 071	149 381	6,6%
Pensionet kontributpaguese të moshës	46 467	48 780	5,0%
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	17 718	19 938	12,5%
Pensionet e Trepçës	1 707	1 382	-19,0%
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	704	777	10,4%
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 284	1 324	3,1%
Skema e të verbërve	1 639	1 873	14,3%
Pensionet Familjare	3 261	2 983	-8,5%
Pensionet e Invalidëve të punës	60	47	-21,7%
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 470	2 971	20,3%
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 908	13 684	6,0%
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 052	12 869	-1,4%
Veteranët	36 767	36 851	0,2%
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 894	3 286	13,5%

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin janar 2024, krahasuar me muajin janar 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-21,7%); skema për pensionet e Trepçës (-19,0%); skema e ndihmës sociale (-10,3%) skema për pensionet familjare (-8,5%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,4%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin janar 2024, krahasuar me muajin janae 2023 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema e kompensimeve për personat e verbër (14,3%); skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (13,5%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (12,5%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (10,4%); skema e pensioneve bazike të moshës (6,6%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (6,0%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (5,0%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,1%); skema për veteranët e luftës (0,2%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin janar 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare